

## RAPORT ZMADHIM KAPITALI

**Përgatitur nga: Eftali Qirjaqi, Auditues Ligjor**

Adresa : Lagjja "Qemal Stafa" , Rr "Studenti" , Shkodër

**Drejtuar :** Z. Kolec Shtjefni dhe z. Alfred Shtjefni, Ortakë të Shoqërisë Tregtare "Agro-Alko" Shpk me nipt. L38518502U, dhe Adresë : Lagjja Zhavor, Rruga e Pistes, Magazine 1-kateshe ne zonen kadastrale nr.1434, nr. pasurie 506/17, ne aksin rrugor Lezhe-Shkoder km 17,Lezhë

Unë Eftali Qirjaqi , Audituese ligjore e liçensuar me numër liçense 11 datë 11.01.2000, pranova misionin e ngarkuar nga Ortaku i "Agro-Alko" Shpk, Shkodër , Z. Kolec Shtjefni & Alfred Shtjefni, për të hartuar raportin e Zmadhimit të kapitalit për këtë shoqëri, si rezultat i kalimit të fitimeve dhe rezervave të krijuara nga burime të brendshme pra nga aktiviteti i shoqërisë.

Vendimi Juaj i marrë me datën 11/06/2021, për zmadhimin e kapitalit themeltar, kërkon që unë si Audituese Ligjore , të bëj verifikimin e dokumentacionit përkatës që lidhet me pasqyrimin e fitimeve dhe rezervave në bilancet e shoqërisë, të dhënat e regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregtar, verifikimin e dokumentacionit kontabël, verifikimin e fitimeve që ka rezultuar në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, paraqitja e rregjistrimeve në kontabilitet. Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e dokumentacionit, siç janë pasqyrat financiare me pjesët përbërese, të hartuara në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit, parimet dhe rregullat e të cilave janë përcaktuar në Ligjin nr.25/2018, datë 10.05.2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" i ndryshuar.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatova se:

Shoqëria "Agro-Alko" shpk, me Nipt L38518502U , seli në Lagjja Zhavor, Rruga e Pistes, Magazine 1-kateshe ne zonen kadastrale nr.1434, nr. pasurie 506/17, ne aksin rrugor Lezhe-Shkoder km 17, Lezhë, është Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar, rregjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me numër çeshtje CN-251228-11-13 date 18/11/2013. Pjesët e kapitalit zotërohen nga ortaku Kolec Shtjefni & Alfred Shtjefni me nga 50 % te kuotave. Kapitali para Zmadhimit paraqitet në ekstrakt dhe pasqyra financiare në vlerën 12,390,000 lekë, i ardhur nga 100 mije lekë kontribut fillestar në të holla në momentin e rregjistrimit të shoqërisë me CN-437700-04-14, shtuar 12,290,000 me CN-809437-06-18 datë 06/06/2018 nga fitimet e kompanisë. Pjesët e kapitalit para zmadhimit zotërohen nga ortaku, Kolec Shtjefni & Alfred Shtjefni me nga 50 % të kuotave. Numri i pjesëve është 100 pjesë dhe vlera e një pjese para zmadhimit është 123,900 lekë. Shoqëria "Agro-Alko" është pajisur me numër unik identifikimi të subjektit (NIPT) L38518502U, Adresa: : Lagjja Zhavor, Rruga e Pistes, Magazine 1-kateshe ne zonen kadastrale nr.1434, nr. pasurie 506/17, ne aksin rrugor Lezhe-Shkoder km 17, Lezhë. Data e themelimit të Shoqërisë 11/11/2013.

- Vendimi i datës 11/06/2021, i ortakëve të shoqërisë, për zmadhimin e kapitalit themeltar, pakësimin e rezervave të investimit, rezervave të tjera dhe fitimit të vitit 2020 është marrë në zbatim të nenit 44 pika c) të ligjit të Shoqërive Tregtare 9901 datë 14/04/2008, neni 81 pika ë) dhe pasi Shoqëria ka aktive per mbulimin e shtimit në formen e aktiveve materiale dhe financiare.



- Rregjistrimet në kontabilitet, të vendimit të ortakut për zmadhimin e kapitalit themeltar me 21,212,000 lekë do të jenë duke shtuar kapitalin themeltar për 21,212,000 leke ne kredi, duke debituar llogaritë e rezervave dhe fitimit te vitit 2020 në po të njëjtën shumë.
- Vendimi i datës 11/06/2021, i ortakëve të shoqërisë, për zmadhimin e kapitalit nga fitimet , rezervat, është marrë pasi Shoqëria ka burime aktive per mbulimin e këtij zmadhimi në formen e aktiveve financiare dhe materiale.
- Rregjistrimet në kontabilitet, të vendimit të ortakut për zmadhimin e kapitalit do të jenë.

**Tabela nr.1**

**VEPRIMET PËR SHTIMIN E KAPITALIT THEMELTAR**

NR	Nr llogarise	Llogaritë	Debitohen (pakësohen)	Kreditohen (Shtohen)
1	101	Kapitali themeltar		21,212,000
2	107/1	Rezerva investimi	8,690,923	
3	107/2	Rezerva të tjera	8,596	
4	109	Fitimi I ushtrimit 2020	12,511,481	
		<b>SHUMA</b>	<b>21,212,000</b>	<b>21,212,000</b>

**Tabela nr.2**

**VEPRIMET MBAS SHTIMIT TË KAPITALIT TË NËNSHKRUAR NGA REZERVAT DHE FITIMIT USHTRIMOR 2020**

NR.R	Nr. llog	Llogaritë	Ishte	Shtuar	Pakesuar	Bëhet
1	101	Kapitali i Nenshkruar	12,390,000	21,212,000		33,602,000
2	107/1	Rezerva investimi	8,690,923	0	8,690,923	0
3	107/2	Rezerva te tjera	8,596	0	8,596	0
4	109	Fitim/Humbja e Vitit 2020	12,511,481	0	12,511,481	0
		<b>SHUMA</b>	<b>33,602,000</b>	<b>21,212,000</b>	<b>21,212,000</b>	<b>33,602,000</b>





## KONKLUZIONE

1. Data e themelimit të Shoqërisë 11/11/2013.
2. Administrator të shoqërisë z.Kolec Shtjefni & Alfred Shtjefni
3. Ortakë para zmadhimit të kapitalit:
  - i. Kolec Shtjefni me 50 % të kapitalit **12,390,000** lekë në shumën 6,195,000 lekë
  - ii. Alfred Shtjefni me 50 % të kapitalit **12,390,000** lekë në shumën 6,195,000 lekë
4. Ortakë mbas zmadhimit të kapitalit:
  - i. Kolec Shtjefni me 50 % të kapitalit **33,602,000** lekë në shumën 16,801,000 lekë
  - ii. Alfred Shtjefni me 50 % të kapitalit **33,602,000** lekë në shumën 16,801,000 lekë
5. Kapitali i themelimit të shoqërisë, i regjistruar para zmadhimit, është **12,390,000**lekë.
6. Shtim kapitali me vendim ortakësh të datës 11/06/2021 me vlerë **21,112,000** lekë, ardhur nga fitimet dhe rezervat.
7. Kapitali i shoqërisë mbas zmadhimit **21,212,000** leke nga **12,390,000**lekë, bëhet **33,602,000** lekë.
8. Kapitali mbas shtimit bëhet **33,602,000** zoteruar 50 % nga Kolec Shtjefni dhe 50% nga Alfred Shtjefni
9. Kapitali në 100 pjesë zotërohet përkatësisht me nga 50 pjesë z, Kolec Shtjefni dhe 50 pjesë z. Alfred Shtjefni
10. Kapitali me vendimin e datës 11/06/2021 zmadhohet me burime të brendshme fitimet e kompanisë.

Drejtimi i shoqërisë të deklaroj vendimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe Institucionet Tatimore brenda afateve ligjore.

Shkodër më 15/06/2021

